



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1049/15 prot.

Datë 01.06.2026

V E N D I M

Nr. 734/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 653/2026, datë 14.05.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”, të ndarë në lote si më poshtë vijon: Numri i referencës së **lotit të III-të**: REF –80425-03-30-2026, me objekt: **Loti i III-të**: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i rrugës “Dhimitër Xhuvani”, me fond limit: **1,506,347.36** (një milion e pesëqind e gjashtë mijë e treqind e dyzet e shtatë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 15,689.48 Euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “TOWER” SHPK me NIPT L21717003H dhe adresë: Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia e Tiranës me adresë: Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 14.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.653/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “TOWER” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”, të ndarë në lote si më poshtë vijon: Numri i referencës së **lotit të III-të**: REF –80425-03-30-2026, me objekt: **Loti i III-të**: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i rrugës “Dhimitër Xhuvani”, me fond limit: **1,506,347.36** (një milion e pesëqind e gjashtë mijë e treqind e dyzet e shtatë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 15,689.48 Euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TOWER” SHPK
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr. 19764 prot., datë 25.05.2026, me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 653/2026 datë 14.05.2026”, protokolluar me tonën nr. 1049/12 prot., datë 28.05.2026 autoriteti kontraktor, njofton se: “.....Autoriteti kontraktor pasi u njoh me Vendimin Nr.653/2026, datë 14.05.2026, mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” Shpk për modifikimin e dokumentave të tenderit, për procedurën e prokurimit

me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”, të ndarë në lote si më poshtë vijon: Numri i referencës së **lotit të III-të**: REF –80425-03-30-2026, vijoi me përgatitjen e ndryshimeve të dokumentave të tenderit në zbatim të vendimit nr.653/2026 të KPP_së. Për shkak të një gabimi njerëzor procedura e prokurimit nuk është pezulluar dhe më pas ka kaluar në hapin e dorëzimit të ofertave. Duke qenë se data e hapjes të kësaj procedure ka qenë 04.05.2026, ora 10:00, nuk është bërë i mundur ngarkimi në sistemin e prokurimit elektronik, të modifikimit të dokumentave të tenderti, pasi procedura ka kaluar në hapin e dorëzimit të ofertave. Në këto kushte, autoriteti kontraktor nuk mundet të pasqyrojë në SPE modifikimet e bëra të dokumentave të tenderit, si dhe as operatorët ekonomik ofertues nuk kanë mundësi të njihen me to. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar në mënyrë që të vijohet me hapat për anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj”
Bashkëlidhur:

-DST e reja të cilat do të rishpallen në zbatim të vendimit të KPP_së nr.653/2026 datë 14.05.2026;
-Formulari i njoftimit të Anulimit;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 19764 prot., datë 25.05.2026, me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 653/2026 datë 14.05.2026”, protokolluar me tonën nr. 1049/12 prot., datë 28.05.2026 autoriteti kontraktor, njofton se, ka zbatuar vendimin Nr.653/2026, datë 14.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe DST e reja të cilat do të rishpallen në zbatim të vendimit të KPP_së nr.653/2026 datë 14.05.2026, si dhe njoftimin për Njoftimin e Anulimit të procedurës me nr. 7733/4 prot., datë 25.05.2026.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (në vijim SPE), konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të publikojë shtojcën me ndryshimet përkatëse referuar vendimit të KPP 653/2026 datë 14.05.2026 dhe për shkak të një gabimi njerëzor ka kaluar në fazën e dorëzimit të ofertave, cka përbën precedenc për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka dërguar më shkresën përcjellëse të sipërcituar, DST e reja të cilat do të rishpallen në zbatim të vendimit të KPP_së nr.653/2026 datë 14.05.2026, si dhe njoftimin për Njoftimin e Anulimit të procedurës me nr. 7733/4 prot., datë 25.05.2026. Nga verifikimi i DST të reja të dëguara nga autoriteti kontraktor, KPP vëren se ato nuk janë hartuar në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin KPP 653/2026 datë 14.05.2026. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për dërgimin në KPP të dokumentave të reja të procedurës që do të rishpallë në përputhje me pikën 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit nr. 653/2026, datë 14.05.2026.

II.3. Në nenin 24 pika 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktorit;”*.

Ndërsa në nenin 118 pika 2 e po këtij ligji parashikohet: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”*

II.4. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të parashikuar nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të K.P.P. Gjykimi i themelit të çështjes gjatë vendimmarrjes së organit kolegjial bazohet në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe materialeve të tjera të administruara gjatë shqyrtimit administrativ. Sa më sipër vendimmarrja e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik përbën dhe zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimmarrjes dhe eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë.

Autoriteti kontraktor, nuk mund të vijojë me hapat e mëtejshëm të anulimit të procedurës objekt ankimi, pasi duhet të marrë masa për dërgimin në KPP të dokumentave të reja të procedurës që do të rishpallë në përputhje me pikën 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit nr. 653/2026, datë 14.05.2026. Pas verifikimi të tyre nga KPP mbi përputhshërimin e hartimit të DST të reja në zbatim të vendimit nr. 653/2026, datë 14.05.2026, Komisioni do shprehet mbi vijueshmërinë e hapave të mëtejshëm të autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”, të ndarë në lote si më poshtë vijon: Numri i referencës së **lotit të III-të**: REF –80425-03-30-2026, me objekt: **Loti i III-të**: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i rrugës “Dhimitër Xhuvani”, me fond limit: **1,506,347.36** (një milion e pesëqind e gjashtë mijë e treqind e dyzet e shtatë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 15,689.48 Euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 653/2026 datë 14.05.2026 të KPP-së.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2026/06/02 11:13:42 +02'00"
2f27ca8769474603834263049e20855a2026060211134
050020

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.06.02
11:16:54